



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 114, Datë 14.05.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEMAN2SUN” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK  
SEMAN – 2, SHEQ MARINAS, FIER, ME FUQI TË INSTALUAR 2000 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a” dhe neni 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neni 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.05.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 2, Sheq Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr. 309 Prot, datë 11.04.2018, shoqëria “SEMAN2SUN” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-2, Sheq Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 KW.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën, nr. 3888/2, datë 29.12.2017, ka dhënë miratimin përfundimtar për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë elektrike Fotovoltaike, në zonën Sheq Marinas-Seman, Fier.
- ERE me vendimin nr. 94, datë 20.04.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman - 2 me kapacitet të instaluar 2000 KW.
- Në vijim të vendimit sipërcituar, me shkresën nr. 55/23 Prot., datë 20.04.2018, u publikua njoftimi në median e shkruar dhe me mbarimin e afateve të publikimit rezultoi se nuk ka asnjë ankesë apo objeksion nga palë të interesuara.

- Gjithashtu ERE me shkresën nr. 309/1 Prot., datë 26.04.2018, i ka kërkuar subjektit të plotësojë dokumentacionin e munguar në aplikim, përsa i përket oponencës teknike të projektit të zbatimit dhe dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare.
- Me shkresën nr. datë 10.05.2018, subjekti ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar si më poshtë:
  - Oponencë teknike e datës 26.04.2018 nga GR ALBANIA, kompani e licencuar në këtë fushë.
  - Konfirmim nga Banka CREDINS nr. 453 Prot., datë 08.05.2018 nga rezulton gjendje e depozitave.
- Pas këtij plotësimi, rezulton se aplikimi i shoqërisë “SEMAN2SUN” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
  - Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionit tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “SEMAN2SUN” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 2, Sheq Marinas, Fier me kapacitet të instaluar 2000 KW, për një afat 20 – vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**